



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:116285

Datë: 11.03.2024

Numri i dokumentit: 05434997

Ac.nr.775/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Naime Ahmeti, kryetare e kolegjit, Halide Reka dhe Adnan Konushevci, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit E.Gj., nga Prizreni, të cilin sipas autorizimit e përfaqësojnë D.M., dhe N.M., avokat nga Prizreni, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “E....”, sh.a, me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqësojnë I.B., dhe V.B., nga Prishtina, me objekt kontesti kompensim i dëmit, duke vendosur sipas ankesës së të autorizuarit të paditurës, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.100/2019 të datës 14.10.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 05.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pathemeltë ankesa e të autorizuarit të paditurës Kompania e Sigurimeve “E.....”, sh.a, me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.100/2019 i datës 14.10.2020, vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.100/2019 të datës 14.10.2020, në pikën një të dispozitivit e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit E.Gj., nga Prizreni. Në pikën dy, ka detyruar të paditurën Kompania e Sigurimeve “E.....”, sh.a, me seli në Prishtinë, që paditësit t’ia paguaj shumën në si në vijim: në emër të dëmit material për veturën e dëmtuar në aksident komunikacioni shumën prej 832.95 euro, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë. Në pikën tre, ka obliguar të paditurën që paditësit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme

prej 833 euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur i autorizuari i të paditurës, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim për Gjykatën e Apelit, që aktgjykimin e atakuar ta prish dhe lëndën t'ia kthej në rivendosje gjykatës së shkallës së parë ose të njëjtin të ndryshoj sipas pretendimeve të paditurës.

Përgjigje në ankesë ka ushtruar e autorizuar e paditësit duke i kundërshtuar pretendimet ankimore, me propozim që Gjykata e Apelit ankesën e të paditurës ta refuzoj si të pabazuar ndërsa të vërtetoj aktgjykimin C.nr.100/19 të datës 14.10.2020.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së neneve 194 dhe 195.1, pika (d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, ka gjetur se:

-Ankesa është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, me padinë e parashtruar në gjykatën e shkallës së parë, të precizuar me parashtrësën e datës 13.10.2020, ka kërkuar që të detyrohet e paditura për kompensimin e dëmit material, në shumë prej 832.95 euro.

Duke vepruar sipas padisë, gjykata e shkallës së parë ka zhvilluar procedurën gjyqësore dhe ka vendosur për aprovimin e të kërkesëpadisë, pas administrimit dhe shqyrtimit të provave: Raporti Evropian mbi aksidentin datë 20.10.2018, nr.1051393/1, procesverbali mbi dëmtimin e automjetit në emër të E.Gj., datë 22.10.2018, raporti për vlerësimin e dëmit të automjetit datë 22.06.2020, nga ekspertit R.Sh., dhe deklarimi i tij në seancë, ekspertiza e aksidentit punuar nga ekspertja E.S., datë 21.09.2020 dhe deklarimi i saj në seancë. Gjykata e shkallës së parë, pas vërtetimit të bazës së kërkesëpadisë e cila është kontestuar nga e paditura, ka vendosur lidhur me lartësinë e kompensimit të dëmit material dhe kamatës duke u bazuar në dispozitën e neni 136, 140, 169, 174 dhe 382 të LMD-së, ndërsa lidhur me shpenzimet e procedurës ka vendosur konform dispozitës së nenit 449 dhe 452.1 të LPK-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 181 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as me shkelje të tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor se aktgjykimi ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, dispozitivit është i pakuptueshëm dhe kontradiktor

me vetveten dhe arsyetimin. Aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitivi i aktgjykimit është i qartë e në harmoni të plotë me arsyetimin e aktgjykimit. Në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadsisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsyeje të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Aktgjykimi përmban edhe referencën sa i përket të drejtës materiale me shpjegime se si është zbatuar e drejta materiale në raport me gjendjen faktike të cilën e ka provuar gjykata e shkallës së parë në këtë çështje kontestuese.

Gjykata e Apelit, nuk mund ta pranoj si të bazuar pretendimin ankimor të paditurës se gjykata e shkallës së parë ka konstatuar në mënyre të gabuar gjendjen faktike pasi që e paditura e ka kontestuar bazën juridike të kërkesëpadsisë. Në rastin konkret, në bazë të Raportit Evropian mbi aksidentin të datës 20.10.2018, me numër serik XXXX/1, paraqitet skica dhe pozita e automjeteve në momentin e ndodhjes së aksidentit dhe se fajin për shkaktimin e aksidentit e kishte drejtuesi i automjetit “I....”, S.G., i siguruar tek e paditura, të cilin raport i ka pohuar i njëjti duke deklaruar se: gjatë vozitjes mbrapa duke dashur të kyqet në rrugë kishte goditur dhe dëmtuar veturën e paditësit. Ndërsa me ekspertizën e ekspertit R.Sh., është përcaktuar lartësia e dëmit material. Duke pasur parasysh faktin se e paditura e ka kontestuar ekspertizën-përkatësisht konstatimin sa i përket lartësisë së çmimit të pjesëve dhe llogaritjes së orëve të punës mirëpo e njëjta nuk ka propozuar nxjerrjen e ekspertizës tjetër apo me grup të eksperteve andaj përfundimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me bazën juridike të kërkesëpadsisë e pranon edhe gjykata ankimore.

Gjykata e Apelit vlerëson se e drejta materiale është aplikuar në mënyrë të drejtë nga gjykata e shkallës së parë, ku me rastin e aprovimit të kërkesëpadsisë së paditëses, aktgjykimin e ka bazuar në dispozita konkrete ligjore që i referohen çështjes e cila është objekt i këtij kontesti në rastin konkret. Me dispozitën 136, paragrafi 1 të LMD-së, është përcaktuar se: *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*. Me vet faktin se e paditura me asnjë provë bindëse e të argumentuar, nuk ka arritur që të provoj pafajësinë e saj, atëherë edhe gjykata e shkallës së dytë të njëjtin e konsideroi si përgjegjës për shkaktimin e dëmit paditësit dhe e obligoi që këtë dëm të njëjtit t’ia kompensoj.

Lidhur me pretendimin se gjykata ka shkelur dispozitat e LMD-së lidhur me kamatën e gjykuar nga data e ushtrimit të padsisë dhe se lartësia e dëmit material është përcaktuar me ekspertizën e makinerisë datë 22.06.2020, dhe se gjykata kamatën është dashur ta aplikoj nga kjo datë e jo siç ka vepruar. Gjykata ankimore një pretendim të tillë nuk mund ta pranoj si të bazuar dhe vlerëson se drejt është vendosur sa i përket kamatës, me të cilën është detyruar e paditura që shumën e gjykuar në emër të dëmit material ta paguaj me kamatë ligjore nga dita e dita e ushtrimit të padsisë, pasi që llogaritja e kamatës duhet të fillon të ecë nga data kur është kërkuar dëmi. Po ashtu, duke u bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të nxjerr nga Gjykata Supreme e Kosovës, ku parashihet që kamata pavarësisht kur është lindur marrëdhënia e detyrimeve për kërkesat që i referohen dëmit material (dëmi i zakonshëm apo fitimi i munguar), kamata fillon

të që rrjedh nga data e parashtrimit të kërkesës së kreditorit për kompensim dhe në rast të mos parashtrimit të kërkesës nga ana e kreditorit për kompensim, atëherë kamata fillon që të rrjedh nga data e parashtrimit të padisë e deri në pagesën e plotë, në rastin konkret dëmi material i cili është shkaktuar, paraqet dëm të zakonshëm për paditësin, dhe se më të drejtë gjykata e shkallës së parë ka vendosur që kamata të llogaritet nga dita e paraqitjes së padisë.

Është vërtetuar edhe vendimi mbi shpenzimet procedurale, duke qenë se gjykata e shkallës së parë, me të drejtë është bazuar në nenin 452 të LPK-së.

Nga të gjitha arsyet e cekura në arsyetim të këtij aktgjykimi të shkallës së dytë, Gjykatës së Apelit i rezulton se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga nenet 194, 195, paragrafi 1, pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.775/2021, me datë 05.03.2024

**Kryetarja e kolegjit
Naime Ahmeti**